



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

Pml.nr.358/2024

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS - kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Mejreme Memaj, kryetare, Rasim Rasimi dhe Afrim Shala, anëtar, me bashkëpunëtoren profesionale Qefsere Berisha, procesmbajtëse, në çështjen penale kundër të dënuarit Xh. L., për shkak të veprës penale lëndimi i rëndë trupor nga neni 186 paragrafi 3 nën paragrafi 3.2 lidhur me paragrafin 2 nën paragrafi 2.2 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK), duke vendosur për kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë të paraqitur nga mbrojtësi i të dënuarit, ushtruar kundër aktgjyqimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë – Dega në Lipjan P.nr. 544/2022 të datës 19.07.2023 dhe aktgjyqimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës PA1.nr.1409/2023 të datës 13.02.2024, në seancën e kolegjit të mbajtur më 15.05.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohet si e pabazuar kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë e mbrojtësit të dënuarit Xh. L., e paraqitur kundër aktgjyqimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë –Dega në Lipjan P.nr.544/23 të datës 19.07.2023 dhe aktgjyqimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës-PA1.nr.1409/2023, të datës 13.02.2024.

A r s y e t i m

Gjykata Themelore në Prishtinë – Dega në Lipjan me aktgjykimin P.nr. 544/2023 i datës 19.07.2023, të dënuarin Xh. L. e ka shpall fajtor për veprën penale lëndimi i rëndë trupor nga neni 186 par.3 nën paragrafi 3.2 me paragrafin 2 nën paragrafi 2.2 të KPRK-së dhe e ka gjykuar me dënim burgimi në kohëzgjatje prej 2 (dy) vite, në të cilin dënim i është llogaritur koha e kaluar në paraburgim prej datës 08.06.2018 deri më 08.09.2018, i cili dënim do të ekzekutohet pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi. I dënuari është obliguar në pagesën e shumës prej 100 €, në emër të paushallit gjyqësor dhe në emër të shpenzimeve të procedurës penale shumë prej

744.96€ dhe për kompensimin e viktimave të krimit shumë prej 20 €. Të dëmtuarit I. L. dhe L.L. për realizimin e kërkesës pasurore juridike janë udhëzuar në kontest civil.

Gjykata e Apelit e Kosovës, me aktgjykimin PA1.nr.1409/2023 të datës 13.02.2024 e ka refuzuar si të pabazuar ankesën e Prokurorisë Themelore në Prishtinë dhe ankesën e mbrojtësit të dënuarit, ndërsa e ka vërtetuar aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë.

Kundër këtyre aktgjykimeve, kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë, ka paraqitur mbrojtësi i të dënuarit, av. Jusuf Bytyqi nga L., për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës penale nga neni 384 par.1.8, si dhe shkeljes së ligjit penal nga neni 385 të KPK-së, me propozim që Gjykata Supreme e Kosovës, ta aprovoj si të bazuar kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë, dhe që mbi këtë bazë çështjen ta kthej në rigjykim dhe rivendosje.

Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit e Kosovës, me shkresën KMLP.II.nr.214/2022 e datës 20.09.2022, ka propozuar që kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë të refuzohet si e pabazuar.

Gjykata Supreme e Kosovës në seancën e kolegjit shqyrtoi shkresat e lëndës në kuptim të nenit 435 paragrafi.1 lidhur me nenin 436 paragrafi.1 të KPP-së dhe pas vlerësimit të pretendimeve në kërkesë, gjeti se:

- kërkesa është e pabazuar.

Në kërkesë mbrojtësi i të dënuarit, thekson se me aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë janë bërë shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale nga neni 384 par.1.8 të KPPRK-së për faktin se edhe aktgjykimi i shkallës së parë dhe aktgjykimi i shkallës së dytë janë të pa kuptueshëm kanë kundërthënie në brendinë e tyre, ose në arsyet e aktgjykimit dhe se aktgjykimet nuk përfshijnë arsyetimin nuk janë paraqitur arsye në lidhje me faktet vendimtare dhe se ato arsye të paraqitura janë të pa qarta dhe ka kundërthënie, aktgjykimet e kundërshtuara janë të mbështetura në prova të papranueshme dhe kjo nga rrethana se gjykatat e instancës më të ulët gjithë besimin ua kanë falë vetëm deklaratave të dëmtuarve, duke vlerësuar si të pa bazuar vetëm deklaratën e të dënuarit Xh. L., kur kihet parasysh fakti se gjatë gjithë ngjarjes së shkaktuar i dënuari ka vepruar në mbrojtje të nevojshme nga se i dënuari ditën kritike kishte qenë i sulmuar nga të dëmtuarit, e i njëjti në vetëmbrojtje u shkakton lëndime të dëmtuarve. Më tutje në kërkesën e mbrojtësit të dënuarit pretendohet se aktgjykimet e kundërshtuara janë të përfshirë edhe me shkelje të ligjit penal nga neni 385 të KPP, ngase janë shkel dispozitat e kodit penal, pasi që në veprimet e të dënuarit Xh. L. në asnjë mënyrë nuk manifestohen elementet qenësore të veprës penale lëndim i rëndë trupor nga neni 186 paragrafi 3 nën paragrafi 3.2 lidhur me paragrafin 2 nën paragrafi 2.2 të KPRK, sepse me asnjë provë të vetme gjykata e shkallës së parë nuk e ka vërtetuar se i dënuari e ka kryer veprën penale, e as që i dënuari i ka sulmuar të dëmtuarit, e as nuk ka pasur për qëllim që tu shkaktoj lëndim tani të dëmtuarve.

Sipas vlerësimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, pretendimet e mbrojtësit të të dënuarit, janë të pabazuara, ngase aktgjykimet kundër të cilave është parashtruar kërkesa nuk përmbajnë shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale e as shkelje të ligjit penal.

Gjykata Supreme e Kosovës, pasi i shikoi shkresat e lëndës dhe analizoi pretendimet e mbrojtësit të të dënuarit, konstatoi se aktgjykimet e gjykatës së shkallës së parë dhe të gjykatës së shkallës së dytë, nuk janë të përfshira me ndonjë shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale dhe as me shkelje të ligjit penal, siç pretendohet në kërkesë, për arsytet që do të paraqiten në vijim. Si aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë, ashtu edhe aktgjykimi i gjykatës së shkallës së dytë përmbajnë të gjitha elementet që kërkohen sipas dispozitave përkatëse ligjore, si në pjesën e dispozitivit, ashtu edhe në pjesën e arsytimit.

Dispozitivi i aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë përmban të gjitha elementet e nevojshme, ashtu siç është parashikuar në nenin 369, paragrafët 3 - 4 të KPP-së dhe kjo pjesë e këtij aktgjykimi, në asnjë rrethanë nuk rezulton që të jetë e paqartë apo në kundërtënie me arsyetimin dhe provat e administruara gjatë shqyrtimit gjyqësor.

Duke ju referuar pretendimeve të mbrojtësit të dënuarit Xh. L., Gjykata Supreme e Kosovës konstaton se në arsyetimin e aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë janë paraqitur arsye të mjaftueshme për të gjitha pikat e aktgjykimit dhe se përshkrimet e dhëna në arsyetim përmbajnë të gjitha arsytet për faktet relevante të cilat janë paraqitur qartë dhe në asnjë mënyrë nuk paraqiten si kundërtënie apo të mangëta. Nga kjo pjesë e aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë rezulton është paraqitur përmbajtja e provave të administruara gjatë shqyrtimit gjyqësor, duke përfshirë këtu dëshmitë e të dëmtuarve –dëshmitarëve L. L. dhe I. L., dëshminë e dëshmitarit I. A., ekspertizen mjeko ligjore të ekspertit dr. F. D. e datës 22.06.2018, raportet mjekësore për të dëmtuarit, mandej janë paraqitur gjetjet dhe vlerësimet e gjykatës në lidhje me shumë çështje të rëndësishme në këtë rast.

Nga arsyetimi i aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë shihet se në këtë rast janë vlerësuar dhe analizuar në mënyrën e duhur të gjitha provat që janë administruar gjatë shqyrtimit gjyqësor, ashtu siç është parashikuar me dispozitat përkatëse ligjore, ku më pastaj, pas një procesi të tillë, janë nxjerrë konkluzionet e caktuara, që kanë të bëjnë si me gjendjen faktike, ashtu edhe aspekte tjera juridike. Në këtë drejtim, rezulton se janë analizuar dhe vlerësuar përveç tjerash, edhe deklaratimet e të dëmtuarve-dëshmitarëve, është vlerësuar ekspertiza mjeko ligjore, provat materiale – raportet mjekësore për të dëmtuarit, si dhe janë vlerësuar edhe pretendimet e caktuara të mbrojtjes, ndërsa më pastaj, janë nxjerrë konkluzione të caktuara, të cilat si të drejta dhe të ligjshme pranohen edhe nga Gjykata Supreme e Kosovës.

Sa i përket çështjes së vërtetimi të gjendjes së fakteve, gjykata e shkallës së parë në arsyetimin e aktgjykimit të saj ka paraqitur arsye të mjaftueshme dhe bindëse në lidhje me atë se pse nuk ja kishte falur besimin pretendimeve të mbrojtjes për faktin se nga provat e administruara të theksuara me lartë është vërtetuar se ditën kritike ashtu siç është e përshkruar në dispozitivin e aktgjykimit të shkallës së parë i dënuari Xh. L. i ka ndërmarr të gjitha veprimet ndaj të dëmtuarve, me që rast

edhe iu ka shkaktuar lëndime të rënda trupore të dëmtuarve dhe me vlerësimin e të gjitha provave të administruara gjykata e shkallës së parë ka vërtetuar në mënyrë të plotë dhe të drejtë gjendjen faktike kur të dënuarin e ka shpallur fajtor. Kjo gjykatë konkludimet e dy gjykatave të instancave më të ulëta i konsideron të drejta dhe të ligjshme pasi që në tërsi është provuar se i dënuari e ka kryer veprën penale për të cilën është shpallur fajtor.

Lidhur me pretendimet e mbrojtësit të dënuarit se i dënuari ka vepruar në mbrojtje të nevojshme, kjo Gjykatë vlerëson se ky pretendim i mbrojtjes është i pabazuar, për faktin se në rastin konkret nuk mund të bëhet fjalë për mbrojtje të nevojshme, i dënuari nuk ka qenë i sulmuar prej të dëmtuarve por përkundrazi i dënuari Xh. L. ka qenë ai që i ka sulmuar të dëmtuarit dhe të dëmtuarve me veprimet e tij të ndërmarra ju ka shkaktuar edhe lëndimet trupore siç janë përshkruar në raportet mjeko ligjore për të dëmtuarit.

Instituti i mbrojtjes së nevojshme ekziston në ato raste kur mbrojtja është e domosdoshme për të zmbrazur sulmin e kundërligjshëm, real dhe të atëçastshëm ndaj vetës ose personit tjetër me kusht që karakteri i mbrojtjes të jetë në proporcion me shkallën e rrezikut që paraqet sulmi.

Sipas vlerësimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, të dy gjykatat e instancës më të ulët, me provat e administruara gjatë shqyrtimit gjyqësor, drejtë kanë vlerësuar se në rastin konkret nuk mund të bëhet fjalë për mbrojtje të nevojshme.

Po ashtu, sipas vlerësimit të Gjykatës Supreme të Kosovës pretendimet e mbrojtësve të dënuarve për shkeljen e ligjit penal janë të pabazuara. Kjo Gjykatë, vlerëson se me aktgjykimet e gjykatave të instancave më të ulëta nuk është shkelur as ligji penal në dëm të të dënuarit Xh. L., sepse nuk është vërejtur se ekziston ndonjë rrethanë që do ta përjashtonte përgjegjësinë penale apo ndjekjen penale të të dënuarit. Të dy gjykatat drejtë kanë vlerësuar se në veprimet e të dënuarit konsumohen të gjitha elementet e veprës penale për të cilën është shpallur fajtor dhe se në rastin konkret është aplikuar drejtë ligji penal dhe se në mënyrë të drejtë janë aplikuar dispozitat ligjore për caktimin e llojit dhe matjes së lartësisë së dënimit për të dënuarin.

Duk u bazuar në arsyet e cekura më lart dhe në bazë të nenit 437 të KPP-së është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS - PRISHTINË

Pml.nr.288/2024, më 15.05.2024

Procesmbajtëse,
Qefsere Berisha

Kryetarja e kolegjit,
Mejreme Memaj